



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.27/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 15.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.27/2025 e datës 13.01.2025.
- II. Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 12,000.00 (dymbëdhjetëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 13.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se në tubimin politik të subjektit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Kryetari kësaj partie Ramush Haradinaj, ka drejtuar akuza të baza dhe të pa vërtetuara, duke cënuar rëndë nenin 34, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës. Më tutje parashtuesi i ankesës thekson se Ramush Haradinaj, duke iu drejtuar me fjalët “duhet me hekë mashtruesin” dhe “dojmë po ashtu me e rrit mbrojtjen, nuk dojmë me bo lojna me sigurinë nacionale pas shpinës së aleatëve tonë, e në interes të Rusisë e Serbisë nga argati i tyre”. Më tej, shkelja e kryetarit të këtij subjekti vazhdon” shko Albin te prokurori, se nuk po dojmë me u vjedhë rezervat shtetërore, buka e ushtarit, as te energjia, shko te prokurori bashkë me hajnat se je shef i hajnave” dhe duke vazhduar me shprehjet “A jeni për me e qu mashtruesin në shpi”, UCK nuk ka mercenarë, ti dhe soji yt jeni mercenarë”. Tutje në ankesë

parashtruesi i ankesës thekson, se në tubimin e njëjtë kandidati tjetër për deputet nga radhët e AAK-së Ardian Gjini thotë “është byro e korrupsionit”, duke potencuar karakteristikat e një regjimi totalitarist të qeverisë së Albin Kurtit.

Sipas parashtruesit të ankesës kandidatët e lartcekur, Haradinaj dhe Gjini, duke drejtuar këto akuza të pabaza dhe të pavërteta ndaj kryeministrit aktual dhe kandidatit për kryeministër nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Albin Kurti, kanë shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenin 34, pika 1.11 të Ligjit, duke kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur si provë një artikull të <https://nacionale.com/politike/shko-albin-shef-i-hajnave-shko-te-prokurori-haradinaj-me-tubim-te-madh-ne-prishtine-hap-fushaten>

Më datë 13.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 14.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 14.01.2025, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe atë për faktin se e gjithë ankesa është parashtruar mbi bazën e një lajmi të publikuar në gazetën Nacionale. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se Gazeta Nacionale në artikullin përkatësisht ka parafrazuar, pra Kryetari i subjektit politik AAK, Ramush Haradinaj, në asnjë pjesë të fjalimit të tij politik të datës 12.01.2025 nuk ka përdorur shprehjet e specifikuar në ankesë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë për më tepër për PZAP, AAK thekson se nuk kemi të bëjmë me shkeljet e pretenduara nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, përkatësisht nenet 34 par.1.11, pasi me këtë dispozitë ligjore qartë është përcaktuar se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohej përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”*

Në përgjigje në ankesë tutje parashtruesi i ankesës thekson se sipas dispozitës së lartcekur rezultojnë se shprehjet e cekura si në ankesën e parashtruar nga LVV, të cilat të vetmin burim e kanë një artikull të gazetës Nacionale, shprehjet të cilat gazeta Nacionale i ka parafrazuar, nuk nxisin apo provokojnë persona të tjerë që të kryejnë ndonjë akt dhune kundër një personi të caktuar, këtu z. Albin Kurti si kryetar i LVV-së. Pra, rrjedhimisht nuk ka arsye për shqetësim se ndonjë person është nxitur për akt dhune sipas fjalimit z. Haradinaj apo z. Gjini. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se i gjithë fjalimi i datës 12.01.2025 ashtu edhe tubimi i mbajtur është zhvilluar në linjën e parimeve të fushatës zgjedhore. Andaj, rrjedhimisht i propozojmë PZAP-së që ankesën me numër Anr.27/2025 të parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj subjektit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të bërë artikullit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar në Gazetën Nacionale prej nga rrjedh se kryetari i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj dhe kandidati për deputet nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe promovimit të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka nxitur urrejtjen ndaj kryetarit të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Albin Kurti në atë mënyrë që përmes përdorimit të gjuhës denigruese dhe urrejtëse ka bërë akuza ndaj kryetarit të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Albin Kurti, dhe atë duke i përdorur fjalët “*duhet me hekë mashtruesin dhe “dojmë po ashtu me e rrit mbrojtjen, nuk dojmë me bo lojna me sigurinë nacionale pas shpinës së aleatëve tonë, e në interes të Rusisë e Serbisë nga argati i tyre”*”, pastaj ka përdorur edhe fjalët “*shko Albin te prokurori, se nuk po dojmë me u vjedhë rezervat shtetërore, buka e ushtarit, as te energjia, shko te prokurori bashkë me hajnat se je shef i hajnave*” si dhe “*A jeni për me e qu mashtruesin në shpi*”, UCK nuk ka mercenarë, ti dhe soji yt jeni mercenarë”.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2014, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara.

Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se “*subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00)euro*”.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj kryetarit të subjektit politik LVV është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik AAK, ka qenë i njoftuar me obligimet

dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje i njëjti e mohon shkeljen e bërë por në të njëjtën kohë thekson që ankesa është e bazuar në lajmin e publikuar në gazetën Nacionale, andaj pretendimet e parashtruar në përgjigje në ankesë për Panelin janë të pabazuara.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 27/2025 më datë 15.01.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.6/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Ragip Namani dhe Rustem Thaqi, anëtarë, lidhur me ankesën Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.27/2025, të datës 15.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 20.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.27/2025, të datë 15.01.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.27/2025, të datë 15.01.2025, ishte vendosur "I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.27/2025 e datës 13.01.2025. II. Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 12,000.00 (dymbëdhjetëmijë) €. III. Detyrohet Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.



Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak siç thuhet në ankesë se; Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe mos vërtetimi i gjendjes reale faktike; Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; Gjoha është shqiptuar përtej kapaciteteve të përcaktuara nga KQZ për Financimin e Subjekteve Politike dhe nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, duke propozuar që gjykata ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet vendimi i kontestuar i PZAP A.nr.27/2025, të datë 15.01.2025, të refuzohet ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.27/2025, të datë 15.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 13.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se në tubimin politik të subjektit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Kryetari kësaj partie Ramush Haradinaj, ka drejtuar akuza të pa baza dhe të pa vërtetuara, duke cenuar rëndë nenin 34, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës. Më tutje parashtuesi i ankesës thekson se Ramush Haradinaj, duke iu drejtuar me fjalët "duhet me hekë mashtruesin" dhe "dojmë po ashtu me e rrit mbrojtjen, nuk dojmë me bo lojna me sigurinë nacionale pas shpinës së aleatëve tonë, e në interes të Rusisë e Serbisë nga argati i tyre". Më tej, shkelja e kryetarit të këtij subjekti vazhdon "shko Albin te prokurori, se nuk po dojmë me u vjedhë rezervat shtetërore, buka e ushtarit, as te energjia, shko te prokurori bashkë me hajnat se je shef i hajnave" dhe duke vazhduar me shprehjet "A jeni për me e qu mashtruesin në shpi", UÇK nuk ka mercenarë, ti dhe soji yt jeni mercenarë". Tutje në ankesë parashtuesi i ankesës thekson, se në tubimin e njëjtë kandidati




tjetër për deputet nga radhët e AAK-se Ardian Gjini thotë është byro e korrupsionit", duke potencuar karakteristikat e një regjimi totalitarist të qeverisë së Albin Kurtit.

Sipas parashtruesit të ankesës kandidatët e lartcekur, Haradinaj dhe Gjini, duke drejtuar këto akuza të pabaza dhe të pavërteta ndaj kryeministrit aktual dhe kandidatit për kryeministër nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Albin Kurti, kanë shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenin 34, pika 1.11 të Ligjit, duke kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur si provë një artikull të medias së shkruar Nacionale.

Me date 13.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 14.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 14.01.2025, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe atë për faktin se e gjithë ankesa është parashtruar mbi bazën e një lajmi të publikuar në gazetën Nacionale. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se Gazeta Nacionale në artikullin përkatësisht ka parafrazuar, pra Kryetari i subjektit politik AAK, Ramush Haradinaj, në asnjë pjesë të fjalimit të tij politik të datës 12.01.2025 nuk ka përdorur shprehjet e specifikuar në ankesë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë për më tepër për PZAP, AAK thekson se nuk kemi të bëjmë me shkeljet e pretenduara nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, përkatësisht nenet 34 par.1.11, pasi me këtë dispozitë ligjore qartë është përcaktuar se: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohet përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë."

Në përgjigje në ankesë tutje parashtruesi i ankesës thekson se sipas dispozitës së lartcekur rezulton se shprehjet e cekura si në ankesën e parashtruar nga LVV, të cilat të vetmin burim e kanë një artikull të gazetës Nacionale, shprehje të cilat gazeta Nacionale i ka parafrazuar, nuk nxisin apo provokojnë persona të tjerë që të kryejnë ndonjë akt dhune kundër një personi të caktuar, këtu z. Albin Kurti si kryetar i LVV-së. Pra, rrjedhimisht nuk ka arsye



për shqetësim se ndonjë person është nxitur për akt dhune sipas fjalimit z. Haradinaj apo z. Gjini. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se i gjithë fjalimi i datës 12.01.2025 ashtu edhe tubimi i mbajtur është zhvilluar në linjën e parimeve të fushatës zgjedhore. Andaj, rrjedhimisht i propozojmë PZAP-së që ankesën me numër Anr.27/2025 të parashtuar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj subjektit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se ankesa është e bazuar Gazetën Nacionale prej nga rrjedh se kryetari i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj dhe kandidati për deputet nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe promovimit të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka nxitur urrejtjen ndaj kryetarit të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Albin Kurti në atë mënyrë që përmes përdorimit të gjuhës denigruese dhe urrejtëse ka bërë akuza ndaj kryetarit të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Albin Kurti, dhe atë duke i përdorur fjalët "duhet me hekë mashtruesin dhe "dojmë po ashtu me e rrit mbrojtjen, nuk dojmë me bo lojna me sigurinë nacionale pas shpinës së aleatëve tone, e në interes të Rusisë e Serbisë nga urgati i tyre", pastaj ka përdorur edhe fjalët "shko Albin te prokurori, se nuk po dojmë me u vjedhë rezervat shtetërore, buka e ushtarit, as te energjia, shko te prokurori bashke me hajnat se je shef i hajnave" si dhe "A jeni për me e qu mashtruesin në shpi", UCK nuk ka mercenare, soji yt jeni mercenare". Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Nr. 01/2014, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".


Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë Kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik



të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Andaj Paneli kishte gjetur se gjuha e përdorur ndaj kryetarit të subjektit politik LVV është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Paneli, me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik AAK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes kishte vlerësuar edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje i njëjti e mohon shkeljen e bërë por në të njëjtën kohë thekson që ankesa është e bazuar në lajmin e publikuar në gazetën Nacionale, andaj pretendimet e parashtruar në përgjigje në ankesë për Panelin janë të pabazuara. Nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të vendimit të atakuar vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren e PZAP-it nr.01/2012, për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave të PZAP-it, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e



paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24.9.1 të Rregullores 01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it. Vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, dhe përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu si thekson parashtruesi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sepse PZAP vendimin e saj e bazon në prova konkrete të qarta dhe ekzistuese si portali Nacionale, që ka vërtetuar pretendimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe janë në lidhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit konkretisht deklaratimet në këtë portal përveç tjerash "punën prapa shpinës dhe në dobi të Rusisë dhe Serbisë", me çka është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti nenin 34. 1.11. ku parashihet se 1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Gjykatës Supreme i rezulton se deklarimi i tillë, pa burim vërtetimi të një fakti të tillë në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €, Gjykata Supreme vlerëson se dënimi i shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 12,000.00 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, me të cilin vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të subjektit politik, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve të tjera, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.



Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e Subjektit Politik për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pa bazuara për faktin se, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se në rastin konkret edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.6/2025, me datë 20.01.2025.

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik